



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.361/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë – Inspektorati i Tregut, rruga Muharrem Fejza Prishtinë, kundër debitorit G.SH. – Operatori ekonomik AZTECH shpk rr. Dëshmorët e Kombit në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, KPPP.nr.1617/22 i datës 31.10.2022, me datën 05.07.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pathemeltë ankesa e debitorit G.SH. – Operatori ekonomik AZTECH shpk rr. Dëshmorët e Kombit në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, KPPP.1617/22 i datës 31.10.2022, Vërtetohet

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1617/22 i datës 31.10.2022, ka vendosur si në vijim, I. Refuzohet prapësimi i debitorit G.SH. – Operatori ekonomik AZTECH shpk rr. Dëshmorët e Kombit në Prishtinë, i shtruar kundër urdhrit përmbartimor P.nr.54/2022 datës 16.03.2022 të përmbartuesit privat Emine Sherifi – Lubeniqi, në Prishtinë, II Mbetet në fuqi urdhri përmbartimor P.nr.54/2022 datës 16.03.2022 i lejuar nga përmbartuesi privat Emine Sherifi – Lubeniqi, në Prishtinë

Kundër këtij aktvendimi ka parashtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i debitorit zyra e avokatëve Hodaj & Partners – Prishtinë, për shkak të shkeljeve të dispozitave të LPP-së, dhe LPK-së, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, KPPP.1617/22 i datës 31.10.2022, të detyrohet kreditori që debitorit t,ia mbuloj të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë – Inspektorati i Tregut, rruga Muharrem Fejza Prishtinë, me datë 16.03.2022, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit G.SH. – Operatori ekonomik AZTECH shpk rr. Dëshmorët e Kombit në Prishtinë, në bazë të dokumentit përmbartues aktvendimit nr.9892 dt.09.12.2021 të I Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë – Inspektorati i Tregut.

Përmbartuesi privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.54/2022 me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues, aktvendimit nr.19/2021 dt.08.12.2021 ndaj debitorit G.SH. – Operatori ekonomik AZTECH shpk, dhe ka detyruar debitorin që kreditorit t,ia paguaj shumën prej 1,000.00€ në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij urdhri si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori ne prapësimin e parashtruar brenda afatit ligjor, ka deklaruar se kundër vendimit në bazë të cilit është iniciuar propozimi për përmbartim, ka paraqitur padi në Gjykatën Themelore Departamenti për çështje administrative, andaj aktvendimi si vendim përmbartues nuk ka titull ekzekutiv dhe i njëjti nuk ka tipare të përmbartueshmërisë. I propozon gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar, të anulohet urdhri përmbartimor, të refuzohet propozimi për përmbartim.

Kreditori në përgjigjen në prapësim deklaron se aktvendimi i kreditorit është dokument i besueshëm, përmban vulën e prerë dhe vulën e ekzekutueshmërisë të Inspektoratit të Tregut, kërkon nga gjykata të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të lejohet zhvillimi i procedurave të përmbartimit në pajtim me LPP-së.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim dhe përgjigjes në prapësim, me aktvendimin KPPP.nr.1617/22 dt.31.10.2022, e Refuzon prapësimin e debitorit sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit Dhomat e shkallës së parë thekson se aktvendimi nr.19/2021 i dt.08.12.2021 i përmban të gjitha elementet e përcaktuara me nenin 27 të LPP-së, dhe kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 36 par.1 të LPP-së, i njëjti vendim përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmëris dt.14.03.2022.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, nisur nga kjo gjendje vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i Dhomës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm pasi aktvendimi i

ankimuar nuk është i përfshirë ne shkelje thelbësore te dispozitave procedurale dhe ligjore nga neni 182 par.2 të LPK-së, dhe nuk ka zbatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ndërsa ka zbatuar drejt dispozitat materiale, për çka edhe Dhomat e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Dhomat e shkallës së dytë ka konstatuar se vendimi i shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar, pasi Dhomat e shkallës së parë, ka analizuar saktë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejt dispozitat ligjore. Shiqvar në shkresat e lëndës shihet qartë se dokumenti bazë në këtë rast- aktvendimi nr.19/2021 i dt.08.12.2021 i nxjerr nga kreditori Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë – Inspektorati i Tregut, rruga Muharrem Fejza Prishtinë, është vendim i ekzekutueshëm që përmban klauzolën e përmbartimit datë 14.03.2022, mbi bazën e të cilit është propozuar përmbartimi, dhe i njëjtit i plotëson arsyet ligjore për tu konsideruar si dokument i besueshëm, në bazë të nenit 37 i LPP-së, si cili përcakton se: *”Kur propozimi për përmbartim paraqitet ne bazë te dokumentit te besueshëm, mjafton qe propozimit ti bashkëngjitet dokumenti i tillë apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*,

Gjykata Komerciale –Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se titulli ekzekutiv-vendimi administrativ nr.19/2021 i dt.08.12.2021, i organit administrativ Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë – Inspektorati i Tregut, i formës së prerë me datë 14.03.2022, është dokument përmbartues dhe i përshtatshëm për përmbartim, dhe si i tillë ky titull ekzekutiv është në pajtim me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“ Dokument përmbartues është edhe vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative dhe akt pajtimi (me tej: ujdia)”* dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbartimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragrafi 3 dhe neni 27 paragraf 1, të po këtij ligji ku përcaktohet se: *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit ”*, ndërsa një dokument përmbartimor për të shërbyer si titull përmbartues patjetër duhet të përmbaj elementet e përcaktuara me nenin 27 paragrafi 1, të cilat e bëjnë si dokument të përshtatshëm përmbartimor.

Dhomat e shkallës së dytë, ka analizuar pretendimet ankimore të debitorit, por i vlerësoj vetëm të natyrës deklarative, të pa argumentuara me dëshmi, për çka të njëjtat i refuzoj si të pabazuara. Nuk mund të pranohen tani në këtë fazë të procedurës përmbartimore pretendimet ankimore sa i përket shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit administrativ nr.19/2021 i dt.08.12.2021, i organit administrativ Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë – Inspektorati i Tregut.

Në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbattoj përmbartimin.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale –Dhomat e Shkallës së Dytë, për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual ne shkallë te dytë bazohet ne dispoziten e nenit 3 par.2 te LPP me te cilën është paraparë se ne shkallen e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë në kuptim të nenit 209, par.1, pika b), të LPK-së e lidhur me nenin 17 të LPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e shkallës së dytë  
K.DH.SH.II nr.361/23 me datë 05.07.2023

Gjyqtari  
Krenar Berisha